



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
13.01.2021

Lënda: Informacion në lidhje me procedurat e ndjekura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për prokurimin sisteme/pajisje të teknologjisë së informacionit për identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin e tyre paszgjedhor.

Nr. Protokolli

312

DREJTUAR: PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

PARTISË DEMOKRATIKE

PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

PARTISË DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET

PARTISË SOCIAL DEMOKRATE

PARTISË BINDJA DEMOKRATIKE

PARTISË DEMOKRISTIANE TE SHQIPËRISË

PARTISË REPUBLIKANE

Të nderuar,

Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ” i ndryshuar, në nenin 22 “**Kompetenca e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje**” parashikon se: “*KQZ-ja ka kompetencë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte dhe/ose procedura të veçanta të procesit zgjedhor; të angazhojë konsulencë të huaj për këtë qëllim, si dhe të prokurorë sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit apo edhe shërbimin e operimit të tyre. KQZ-ja është e detyruar që përdorimin e sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit ta zbatojë në zgjedhje nëpërmjet projekteve pilot, në jo më pak se 10 për qind të numrit të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit*”.

Në nenin 179 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar parashikohet se: “*1. Sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që do të përdoren në zgjedhje do të implementohen me projekte pilot, të cilat duhet të përfshijnë jo më shumë se 20 për qind të zgjedhësve, duke filluar nga zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pavarësisht nga ky rregull, në zgjedhjet e para për Kuvendin, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, identifikimi elektronik do të shtrihet në 100 për qind të votuesve. 2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë alokon në buxhetin e KQZ-së fondin e nevojshëm për prokurimin, jo*



më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3.Procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve dhe implementimin e teknologjisë që do të përdoret në zgjedhje do të kryhen sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik, me një nga procedurat më afatshkurtra që lejon ky ligj për këtë prokurim”,

Në zbatim të dispozitave të mësipërme të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nxorrën urdhërin nr. 82, datë 31.10.2020, *“Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit”.*

Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me vendimin nr. 02 datë 31.10.2020 miratoi *“Llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë ”*, duke parashikuar shprehimisht në pikën 8 të tij se: *“Me qëllim implementimin dhe përdorimin e sistemit elektronik të identifikimit të votuesve, në zgjedhjet për Kuvend 25 prill 2021, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër të KQZ-së si dhe referuar parashikimit ligjor nën 179 pika1 të Kodit Zgjedhor, Autoriteti Kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit të parashikuar në nenin 33 , pika 1, gërma c, të ligjit të “Për Prokurimit Publik”.*

Bazuar në dispozitat e sipërcituara të Kodit Zgjedhor si dhe, në nenin 33, pika 2 gërma “c” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, në nenin 36 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor (KQZ) zhvilloi procedurën prokuresë negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Grupi i punës i ngritur në KQZ për këtë qëllim u dërgoi ftesë për përlllogaritje të kostos financiare 20 kompanive që kishin objekt të veprimtarisë së tyre kontrata të ngjashme në fushën e zgjedhjeve. Nga këto kompani, 8 prej tyre iu përgjigjën kërkesës së KQZ-së në lidhje me përlllogaritjen e kostos financiare të këtij projekti. Në vijim, këtyre 8 kompanive iu dërgua një informacion dhe njoftim mbi regjistrimin në sistemin e prokurimeve elektronike për t’u bërë pjesë e procedurës prokuresë që do të zhvillonte KQZ, sipas legjislacionit mbi prokurimin publik në fuqi.



Vetëm 6 kompani rezultuan se kishin përfunduar procesin e regjistrimit në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, për rrjedhojë vetëm këto 6 kompani morën ftesën për pjesëmarrje në procedurën prokuruese.

Data 5 janar 2021 ishte afati i fundit për paraqitjen e ofertës nga këto 6 kompani të ftuara për të prezantuar ofertën e tyre.

Rezultoi se vetëm kompania “Smartmatic” kishte dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në sistem, si dhe paraqiti brenda afatit të vendosur nga Autoriteti Kontraktor pajisjen/mostrën "demo"-n e kërkuar.

Aktualisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është në fazën e vlerësimit të ofertës ekonomike dhe të zgjedhjes teknike që ka ofruar operatori ekonomik “Smartmatic”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpreh gatishmërinë për të vënë në dispozicionin tuaj çdo informacion tjetër të nevojshëm për projektin e identifikimit elektronik

Duke ju falenderuar paraprakisht,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

